



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:184310

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 06348855

C.nr. 1277/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florid Hasku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve 1. Rr. D., nga Gjakova dhe 2. S. H., nga Gjakova, të cilat me autorizim i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti për kompensimin e pagës shtesë, vlera e kontestit 900.00 euro, në shqyrtimin kryesor - publik të mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 16.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e të paditësve 1. Rr. D., nga Gjakova dhe 2. S. H., nga Gjakova.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Rr. D., në emër të punës së kryer për ditët të fundjavës, gjatë periudhës kohore prej 15.05.2021 - 26.02.2022 (*për gjithsej 60 orë pune*), ti kompensoj pagën shtesë në lartësi prej 83.79 euro, me kamat ligjore 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data 02.09.2022 (*datë e paraqitjes së padisë*), e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të kontributeve për Trustin Pensional të Kosovës t'ia paguaj shumën prej 4.41 euro, ashtu që të gjitha këto të paguaj në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit S. H., në emër të punës së kryer për ditët të fundjavës, gjatë periudhës kohore prej 15.05.2021 - 26.02.2022 (*për gjithsej 72 orë pune*), ti kompensoj pagën shtesë në lartësi prej 103.97 euro, me kamat ligjore 8 % në vit, e cila do të llogaritet nga data 02.09.2022 (*datë e paraqitjes së padisë*), e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të kontributeve për Trustin Pensional të Kosovës t'ia paguaj shumën prej 5.47 euro dhe në emër të Tatimit në burim për Administratën Tatimore të Kosovës t'ia paguaj shumën prej 0.96 euro, ashtu që të gjitha këto të paguaj në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.
- IV. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses 1. Rr. D., nga Gjakova dhe 2. S. H., nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, sa i përket kërkesës për periudhën prej datës 03.09.2019 e deri në 14.05.2021.

- V. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditësve t'ia paguaj shumën prej 708.20 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

### A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datë 02.09.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e pagës shtesë nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 900.00 euro.

#### *1. Pretendimet të palëve*

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndrojnë në tërësi pranë padisë si dhe parashtrësës së precizuar, theksojmë se objekti i këtij kontesti ka të bëjë me kompensimin e pagës shtesë në sajë të punës së kryer nga paditësit gjatë fundjavës. Paditësit në kuptim të nenit 261 të LPK e bëjnë tërheqjen e padisë nga 03.09.2019 e deri më 14.05.2021, ashtu që padia do të konsiderohet sikurse të mos ishte paraqitur fare. Tani e tutje objekt i shqyrtimit në këtë çështje mbetet kompensimi për periudhën kohore 15.05.2021 deri më 26.02.2022, ashtu që për këtë periudhë kohore paditësit kanë qenë të pranishëm në punë për 12 ditë të fundjavës përkatësisht paditësja Rr. D. ka punuar 60 orë pune dhe paditësja S. H. ka punuar 72 orë pune. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar fakti se ndërgjyqësit janë në marrëdhënie pune, është vërtetuar fakti se paditësit kanë punuar gjatë fundjavës si dhe është vërtetuar lartësia e pagës bazë, kurse sa i përket borxhit kjo është përlllogaritur saktë përmes ekspertizës financiare. Baza juridike e padisë mbështetet në nenin 56 paragrafi 2 të LP-së bazë kjo e cila përpos gjykatave të rregullta është vërtetuar edhe me vendimin KI 37/22 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Pretendimit i të paditurve se paditësit janë kompensuar edhe gjatë ditëve që nuk kanë punuar dhe se e paditura i ka kryer të gjitha obligimet janë pa relevanc në këtë çështje si dhe deklarimeve të pa mbështetura në prova e kjo për shkak se sikur e paditura ti kishte kompensuar për punën shtesë nuk do të iniciohej ky kontest. Nga të gjitha këto që u thanë gjykatës i propozojmë që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe ashtu siç është precizuar me parashtrësë. Shpenzimet procedurale i kërkojmë dhe atë taksa gjyqësore 20 euro, përpilimi i padisë për dy paditës 117 euro, përpilimi i parashtrësës për precizim 117 euro, përfaqësimi në 2 seanca nga 152.10 euro, përkatësisht 304.20 euro, si dhe pagesa e ekspertizës financiare në lartësi prej 150 euro, e që në tërësi kërkojmë shpenzimet e procedurës në lartësi 708.20 euro.

E paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndrojnë pranë kundërshtimeve si në përgjigje në padi duke vazhduar të kundërshtojë edhe me tej padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar si për nga baza ashtu edhe nga lartësia, po ashtu duke u bazuar e në vendimin e MASHTIT me numër 01/B-1860 i datës 28.09.2021, vërtetohet se e paditura nuk ka detyruar paditësen të punojë gjatë fundjavës siç pretendohet këtu në Padi duke ju referuar nenin 56 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit të punës, sepse ky vendim nuk ju referohet rasateve kur kemi të bëjmë me orët e humbura por kemi të bëjmë me raste të orëve të humbura me orët e humbura gjatë COVID-19. Vlen të theksohet se paditësit janë paguar nga e paditura pandërprere edhe gjatë periudhës së pandemisë pa qenë fare prezentë në punë, këto pagesa janë bërë për pagat e tyre sipas kontratave. Lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e paditura konsideron se kjo kërkesëpadi është parashtruar komfom ligjit të punës dhe LMD-së. Nuk e kundërshtojë tërheqjen e padisë të paditësve

për periudhën e cekur nga i autorizuari i tyre. Në fund i propozojnë gjykatës që ta refuzojë si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses.

## *2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor*

Për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore Gjykata ka administruar provat si në vijim: Ekspertiza financiare e datës 13.06.2024, Listat e pagave për vitet 2021 dhe 2022 për secilin paditës veç e veç; Vërtetimi i dt. 23.05.2021, nr. prot. 1819/22 i lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, në emër të paditësit Rr. D.; Vërtetimi i dt. 23.05.2021, nr. prot. 1820/22, të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, në emër të S. H.; Vërtetimi i dt.21.02.2024, nr. prot. 1868/24, të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, në emër të paditësit Rr. D.; Vërtetimi i dt.21.02.2024, nr. prot. 1867/24, të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, në emër të paditësit S. H.; Kontrata e punës e lidhur mes të paditurës dhe paditësit Rr. D., e dt. 01.09.2015, me nr. prot. 19/1; Kontrata e punës e lidhur mes të paditurës dhe paditësit S. H., e të dt. 01.09.2015, me nr. prot. 20/1; Vendimi i dt. 28.09.2021, me nr. 01/B nr. prot. 1860, të lëshuar nga MASHT-i - Kabineti i Ministrit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr. 06/L-003 për Procedurën Kontestimore (tutje: LPK-së), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi si e bazuar.

## *3. Gjendja faktike e vërtetuar*

Në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht si mësimdhënës në SHFMU “At Gjergj Fishta” në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, sipas Kontratave të punës si më lartë, të lëshuara nga Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura.

Tutje në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditëses Rr. D. dhe S. H., sipas Vërtetimi i dt.21.02.2024, nr. prot. 1868/24, të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin Bishtazhin – Gjakovë dhe Vërtetimi i dt.21.02.2024, nr. prot. 1867/24, të lëshuar nga SHFMU “At Gjergj Fishta”, në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, paditëset gjatë periudhës kohore prej datës 15.05.2021 deri më 26.02.2022, kanë punuar dymbëdhjetë (12) ditë të shtune, respektivisht paditësja Rr. D. ka punuar 60 orë pune dhe paditësja S. H. ka punuar 72 orë pune.

Gjykata me leximin e listave të pagës të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për secilin paditëse veç e veç, ka vërtetuar faktin se paditëset kanë realizuar pagë mujore, për punën e kryer pranë të paditurës.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Nga leximi i ekspertizës financiare të hartuar nga Fatmir Gashi, ekspert financiar, me datë 13.06.2024, në përputhje me detyrat e përshkruara nga gjykata, ka bërë llogaritjen matematikore përkatëse lidhur me kërkesat e parashtruar nga ana e paditësve, për kompensimin të orëve mbi normën e punës (mësimor) dhe atë për periudhën 15.05.2021 e deri me datë 26.02.2022, dhe ka përcaktuar lartësinë e secilës kërkesës në shumën konkrete, dhe atë: për paditësin e parë Rr. D., nga përllogaritja sipas ekspertizës financiare, e njëjta do të duhej te kompensohet për 60 orë punë së kryer gjatë fundjavës shumë prej 83.79 euro, në emër të kontributeve për Trustin Pensional të Kosovës shumë prej 4.41. euro, si dhe për paditësen e dytë S. H., nga përllogaritja sipas ekspertizës financiare, e njëjta do të duhej te kompensohet për 72 orë punë mbi punën gjatë fundjavës 103.97 euro, në emër të kontributeve për Trustin Pensional të Kosovës shumë prej 5.47 euro dhe në emër të Tatimit në burim për Administratën Tatimore të Kosovës t'ia paguaj shumë prej 0.96 euro.

Gjykata, përmes ekspertizës financiare të lartpërmendur, ka arritur të vërtetoj faktin e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për periudhën 15.05.2021 e deri me datë 26.02.2022, nuk i ka kompensuar në emër të orëve shtesë (mbi normë) për paditësit të lartcekur.

#### 4. Baza ligjore e kërkesëpadisë

Bazuar në dispozitat të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, konkretisht në nenin 55 paragrafi 1 përcakton se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”* si dhe në paragrafin 2 parashihet se *“të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*.

Ndërsa në dispozitën e nenit 56 të po këtij ligji në paragrafin 1 parashihet *“Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.”* lidhur me paragrafin 2 i cili ka përcaktuar: *“2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë: 2.1. 20 % në orë për kujdestari; 2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës; 2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit; 2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.”* dhe paragrafi 3 të po këtij ligji ka paraparë *“3. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra tjetrën”*

#### 5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Nuk ishte kontestues as fakti se paditëset kanë realizuar pagë mujore, për punën e kryer pranë të paditurës. Nuk ishte kontestues as fakti se paditëset kanë punuar gjatë fundjavës për 12 ditë pune, respektivisht paditësja Rr. D. ka punuar 60 orë pune dhe paditësja S. H. ka punuar 72 orë pune (mbi normë). Megjithatë, kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë, se a kanë bazë ligjore për të kërkuar paditësit kompensimin e pagës shtesë nga e paditura apo jo, në emër të punës gjatë fundjavës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovet. Kjo

ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHFMU “At Gjergj Fishta” në fshatin Bishtazhin - Gjakovë, që gjë dëshmohet nga kontratat e punës për secilën paditëse si dhe nga vërtetimet për prezencën në shkollë gjatë ditëve të shtunave, gjatë periudhës 15.05.2021 deri më 26.02.2022. Në rastin konkret, gjykata gjatë vendosjes lidhur me këtë çështje vlerësoi Nenin 55 paragrafi 1 dhe 56 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, përmbajtja e të cilëve u paraqit më lart.

Gjykata ka aprovuar lartësinë e shumave të kërkuara nga palët paditëse, duke u mbështetur në ekspertizën financiare, të hartuar nga ekspertja financiar. Këtë ekspertizë, gjykata e vlerësoi si të hartuar në përputhje me rregullat e shkencës dhe profesionit, si dhe në përputhje të plotë me provat e dorëzuara e të administruara nga gjykata në këtë çështje kontestimore. Eksperti financiar, po ashtu ka qenë prezent në seancën gjyqësore, e të cilën ka dhënë sqarimet e nevojshme për ekspertizën e hartuar. Pala e paditur, në asnjë rast nuk e ka kundërshtuar ekspertizën financiare, e as nuk ka pasur ndonjë propozim për plotësimin e së njëjtës, ose për hartim të ekspertizës së re financiare.

Gjykata vendimin e vet e bazoi në nenin 56 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës. Ky vendim u bazua edhe në lidhshmëri me provën, përkatësisht vërtetimin për ditët e prezencës në punë gjatë fundjavës si dhe nga ekspertiza financiare e hartuar nga eksperti financiar, nga e cila rezulton që paditëset e lartcekura gjatë periudhës 15.05.2021 deri më 26.02.2022, kanë punuar gjithsej 12 ditë të shtune, respektivisht paditësja Rr. D. ka punuar 60 orë pune dhe paditësja S. H. ka punuar 72 orë pune. Rrjedhimisht, sipas kësaj dispozite, paditëset duhet që të kompensohen në pagë shtesë në përqindje të pagës bazë dhe atë 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës. Duke marrë parasysh se ekspertiza financiare ka përcaktuar kompensimin për punë shtesë për secilën paditëse veç e veç, gjykata erdhi në përfundim se paditësve ju takon kompensimi si në shumat të aprovuara si nën pikën II dhe III të dispozitiv të këtij aktgjykimi, aq sa ishte edhe kërkesa e paditësve.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se kërkesa është e parashkruar, është në tërësi e pabazuar, pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 02.09.2022, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre (3) viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Sa i përket pretendimit të të paditurës lidhur me Vendimin me nr. 01/B-1860 të dt. 28.09.2021 të lëshuar nga MASHT-i, Kabineti i Ministrit, gjykata konstaton se me këtë vendim janë kompensuar ditët e mësimit të humbura për shkak të gjendjes me Pandemin COVID -19, mirëpo në mes palëve kontestuese është kompensimi i pagesës shtesë (mbi normë) për këto ditë, të cilët paditëset janë angazhuar, andaj në bazë të saj është argumentuar se paditëset, respektivisht mësime të mësimit janë angazhuar në ditët 12 ditë e mësimit gjatë të shtunave, por të cilët nuk janë kompensuar në pagesë shtesë.

Gjykata në procedurën e provave administroi të gjitha provat e parashtruara nga palët kurse në arsyetimin e aktgjykimit ju referua vetëm provave që ishin me ndikim vendimtar në marrjen e aktgjykimit.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë, vetëm sa i përket borxhit kryesor dhe nuk rrjedh për shumat e

aprovuar në emër të Trustin Pensional të Kosovës si dhe në emër të Tatimit në burim për Administratën Tatimore të Kosovës.

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit në mbështetje të nenit 261.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) i cili parasheh se *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”* pasi që edhe e paditura nuk e ka kundërshtuar të njëjtën gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar të tërhequr padinë e paditëseve, sa i përket kërkesës për periudhën prej 03.09.2019 e deri në 14.05.2021.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, me ç’rast paditësve iu pranua shumica e shpenzimeve në vlerë të përgjithshme prej 708.20 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (*e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore*), si dhe për përpilimin e padisë për dy (2) paditës shumë prej 117.00 euro, për përpilimi e parashtrësës për precizim shumë prej 117.00 euro, për përfaqësimi në dy seanca nga 152.10 euro, përkatësisht shumë prej 304.20 euro, këto të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe pagesa e ekspertizës financiare në lartësi prej 150 euro.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK -së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.1277/22, më datë 16.07.2024

Gj y q t a r i  
Florid Hasku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.